



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

MEKANIKE

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

K-F-IV-25

Tiranë, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtje

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi	4
Kriteret e përgjithshme të pranimi	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
Struktura e kualifikimit.....	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	6
NjN-06-IV-0261-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikë	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	6
Kritere vlerësimi	7
NjN-06-IV-0262-25 Proceset e prodhimit në mekanikë	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	8
Kritere vlerësimi	8
NjN-06-IV-0263-25 Cilësia e produkteve të prodhuara në mekanikë.....	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	9
Kritere vlerësimi	9
NjN-06-IV-0264-25 Mirëmbajtje dhe riparime mekanike.....	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kritere vlerësimi	10
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	11
Kritere vlerësimi	11
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kritere vlerësimi	12
NjN-06-IV-0265-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në mekanikë.....	12

Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	13
Kritere vlerësimi	13
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	14
Modalitetet e vlerësimit	14
Informacion shtesë	15
SHËNIM	15

Emërtimi i kualifikimit	MEKANIKE			Kodi
Kohëzgjatja	1500 orë nocionale	Niveli	Niveli IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	K-F-IV-25
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “ Mekanikë ”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK , është të përgatisë specialistë të nivelit teknik/menaxher në fushën e mekanikës, për t’u punësuar në veprimtaritë e menaxhimit të kësaj fushe apo për krijimin e menaxhimit të një biznesi privat.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “ Mekanikë ”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK , kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, të kualifikimit profesional “Mekanikë”; – janë në gjendje shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “ Mekanikë ”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK , e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli si teknik/menaxher i mesëm në këtë kualifikim profesional. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në kualifikimin profesional “Mekanikë”, si teknik i mesëm. Gjithashtu, individë mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mekanikës, në profesione të cilat lidhen me teknologjitë e prodhimit (axhustator, tornitor, frezator etj.) të përpunimit të materialeve metalike, jometalike, si dhe në mirëmbajtjen dhe riparimin e makinerive industriale. Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “ Mekanikë ”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK , i jep individit të drejtën për Diplomën e Maturës Shtetërore Profesionale. Me përfundimin e këtij niveli, individë ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim profesional duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	F-III-15; F-IV-19			

Struktura e kualifikimit profesional

Në përfundim të arsimit profesional “**Mekanikë**” **niveli IV të KSHK**, referuar nivelit IV të KEK, individit do të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënës të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënës.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe t'i shpërndajë ato, në dobi të kolegëve dhe punonjësve në njësinë e tij/saj prodhuese;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të ndërmarrë apo hedhë vazhdimisht ide, duke hartuar projekte, struktura të reja tekniko organizative për përmirësimin e strukturave ekzistuese;
5. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
6. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
7. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
8. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
9. Të demonstrojë maturi me eprorët, vartësit, partneret, etj;
10. Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij/saj dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
11. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë në arritjen e objektivave të pranuar;
12. Të vlerësojë të tjerët dhe vetëvlerësojë aftësitë e tij/saj, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
13. Të jetë i hapur dhe të veprojë si ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes së tij dhe të tretëve jashtë saj, si: furnitorët, klientët, partnerët, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësisë prodhuese;
14. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
15. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
16. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
17. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të qenë pjesëmarrës aktiv në grup;
18. Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
19. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;

20. Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar ide të reja;
21. Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
22. Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënës (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-06-IV-0261-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikë

Rezultatet e të nxënës në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrën e organizimit të ndërmarrjes/repartit të prodhimit industrial;
2. Të argumentojë mënyrën e vendosjes së makinerive dhe pajisjeve në repartin e prodhimit;
3. Të përshkruajë linjat e prodhimit dhe llojet e tyre;
4. Të analizojë sipas standardeve të projektimit projektet, vizatimet dhe skicat;
5. Të shpjegojë radhën e punës sipas procesit të prodhimit dhe urdhrit të punës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe përzgjedhjes së mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës;
7. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe përzgjedhjes së materialeve dhe pjesëve të këmbimit, sipas përdorimit dhe karakteristikave të tyre;
8. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe përzgjedhjes së burimeve njerëzore të nevojshme sipas kompetencave profesionale;
9. Të përshkruajë mënyrat e llogaritjes së kohës së punës gjatë proceseve të prodhimit;
10. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionimit të mjeteve, makinerive, pajisjeve etj.;
11. Të shpjegojë rëndësinë e matjeve dhe instrumenteve matëse dhe kontrolluese;
12. Të shpjegojë mënyrat e zbatimit të planit të punimeve;
13. Të shpjegojë mënyrat e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
14. Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit me specialistë të tjerë;
15. Të argumentojë rëndësinë e mbarëvajtjes së punës në ekip;
16. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të pastrimit dhe sistemimit të veglave dhe vendit të punës para, gjatë dhe pas punës;
17. Të shpjegojë llojet e dokumentacionit teknik dhe ekonomik për regjistrimin e proceseve të punës;
18. Të përshkruajë format e raportimit për ecurinë e punës.

Rezultatet e të nxënës në shprehje profesionale

1. Të menaxhojë burimet materiale të nevojshme sipas procesit të prodhimit;
2. Të menaxhojë burimet njerëzore të nevojshme sipas procesit të prodhimit;
3. Të dokumentojë dhe raportojë realizimin e detyrave sipas procedurave.

Kriteret e vlerësimit

- Organizon ndërmarrjen/repartin e prodhimit industrial, sipas specifikave të procesit të prodhimit;
- Mbikëqyr vendosjen e makinerive dhe pajisjeve në repartin e prodhimit, sipas specifikave të procesit të prodhimit;
- Mbikëqyr zbatimin e projekteve në repartin e prodhimit sipas standardeve;
- Mbikëqyr planifikimin dhe përzgjedhjen e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve të punës, sipas specifikave të procesit të prodhimit;
- Mbikëqyr planifikimin dhe përzgjedhjen e materialeve dhe pjesëve të këmbimit, sipas specifikave të procesit të prodhimit;
- Mbikëqyr përzgjedhjen e instrumenteve matës, sipas procesit të prodhimit;
- Planifikon burimet njerëzore të nevojshme sipas kompetencave profesionale;
- Menaxhon burimet njerëzore të nevojshme sipas kompetencave profesionale;
- Kryen saktë llogaritjen e kohës së punës gjatë proceseve të prodhimit;
- Mbikëqyr zbatimin e kohës së punës gjatë proceseve të prodhimit;
- Mbikëqyr zbatimin e proceseve të prodhimit, sipas kartës teknologjike;
- Kryen kontrollin e funksionimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive, sipas rregullores së brendshme;
- Përgatit urdhrin e punës sipas procesit të prodhimit;
- Mbikëqyr zbatimin e urdhrit të punës, sipas rregullores së brendshme;
- Mbikëqyr organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike sipas standardeve përkatëse;
- Bashkëpunon me specialistë të tjerë për koordinimin e punës, sipas rastit;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e veglave dhe vendit të punës (para, gjatë dhe pas punës) sipas manualeve përkatëse dhe rregullores së brendshme;
- Dokumenton punën e kryer sipas procesit të punës;
- Kryen raportime për ecurinë e punës sipas rregullores së brendshme.

NjN-06-IV-0262-25 Proceset e prodhimit në mekanikë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të katalogëve dhe manualeve teknike të regjimeve dhe operacioneve të punimit;
2. Të shpjegojë veçoritë e procesit të prodhimit dhe procesit teknologjik;
3. Të shpjegojë veçoritë e analizës konstruktive dhe teknologjike të detalit;
4. Të interpretojë llojet e proceseve të prodhimit me axhustim dhe specifikat e tyre;
5. Të interpretojë llojet e proceseve të prodhimit me saldimit dhe specifikat e tyre;
6. Të interpretojë llojet e proceseve të prodhimit me fonderi dhe specifikat e tyre;
7. Të interpretojë llojet e proceseve të prodhimit me deformim plastik dhe specifikat e tyre;
8. Të interpretojë llojet e proceseve të prodhimit me heqje ashkle dhe specifikat e tyre;
9. Të interpretojë llojet e proceseve të prodhimit me teknologji speciale dhe specifikat e tyre;

10. Të interpretojë mënyrat e kryerjes së matjeve;
11. Të shpjegojë llojet e parregullsive të proceseve të prodhimit dhe shkaqet e tyre;
12. Të shpjegojë rëndësinë e marrjes së masave për eliminimin e parregullsive;
13. Të identifikojë llojet e kostove shtesë gjatë proceseve të prodhimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë katalogët dhe manualët teknike të regjimeve dhe operacioneve të punimit;
2. Të mbikëqyrë proceset e prodhimit industrial me specifikat e tyre;
3. Të identifikojë parregullsitë që ndodhin gjatë proceseve të prodhimit industrial.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr zbatimin e përdorimit të katalogëve dhe manualeve teknike të regjimeve dhe operacioneve të punimit;
- Analizon parametrat e procesit të prodhimit dhe faktorët e procesit teknologjik;
- Mbikëqyr zbatimin e proceseve të prodhimit me axhustim sipas specifikave të tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e proceseve të prodhimit me saldim sipas specifikave të tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e proceseve të prodhimit me fonderi sipas specifikave të tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e proceseve të prodhimit me deformim plastik sipas specifikave të tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e proceseve të prodhimit me heqje ashkle sipas specifikave të tyre;
- Mbikëqyr zbatimin e proceseve të prodhimit me teknologji speciale sipas specifikave të tyre;
- Kryen matje gjatë proceseve të prodhimit, sipas standardeve;
- Identifikon parregullsitë e proceseve të prodhimit dhe shkaqet e tyre, sipas rastit;
- Mbikëqyr procedurat për eliminimin e parregullsive, sipas rastit;
- Përlllogarit kostot shtesë gjatë proceseve të prodhimit, sipas rastit.

NjN-06-IV-0263-25 Cilësia e produkteve të prodhuara në mekanikë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit përfundimtar të produkteve të prodhuara;
2. Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit me specialistët përkatës për kontrollin përfundimtar të produkteve të prodhuara;
3. Të shpjegojë rëndësinë e përputhshmërisë së materialeve të përdorura duke u bazuar në kartën teknologjike;
4. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të manualeve të instrumenteve matës dhe kontrollues;
5. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të rregullsisë dhe kalibrimit të instrumenteve matës;
6. Të shpjegojë metodat e kontrollit përfundimtar të produkteve të prodhuara duke u bazuar te karta teknologjike;
7. Të identifikojë parregullsitë e produkteve të prodhuara;
8. Të interpretojë rëndësinë e informimit të specialistëve për parregullsitë e produkteve të prodhuara;
9. Të përshkruajë domosdoshmërinë e dokumentimit të kontrollit të cilësisë së produkteve të

prodhuara.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin e cilësisë së produktit përfundimtar.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon procedurën për kontrollin përfundimtar të produkteve të prodhuara;
- Bashkëpunon me specialistët përkatës për problematikat dhe të rehat në fushën e kontrollit të cilësisë;
- Kontrollon përputhshmërinë e materialeve të përdorura duke u bazuar në kartat teknologjike;
- Përdor saktë manualët e përdorimit të instrumenteve matës dhe kontrollues;
- Kryen kontrollin përfundimtar të produkteve të prodhuara, sipas standardeve;
- Identifikon parregullsitë e produkteve përfundimtare, sipas standardit;
- Raporton për parregullsitë e identifikuar, sipas rregullores së brendshme;
- Dokumenton procesin e kontrollit përfundimtar të cilësisë për produktet e prodhuara, sipas rregullores së brendshme.

NjN-06-IV-0264-25 Mirëmbajtje dhe riparime mekanike

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë proceset e mirëmbajtjes dhe riparimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
2. Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit me specialistët përkatës për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes në kohë të riparimeve dhe mirëmbajtjes;
4. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së proceseve të mirëmbajtjes së makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës bazuar në rekomandimet e prodhuesit;
5. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të kalendarit periodik të shërbimeve të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
6. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së plotësimit të librit të shërbimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
7. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kalendarit të kolaudimeve periodike të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
8. Të shpjegojë rëndësinë e kalibrimit të makinerive dhe pajisjeve të punës;
9. Të shpjegojë rëndësinë e informimit të specialistëve për parregullsi në makineritë, mjetet dhe pajisjet e punës;
10. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes për riparimin e defekteve në pjesët mekanike;
11. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së çmontimit/montimit dhe zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
12. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së regjistrimit të detaleve dhe nyjeve pas riparimit /zëvendësimit;

13. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së procesit të vajosjes dhe grasatimit;
14. Të identifikojë parregullsitë pas riparimit dhe të marrë masa për korrigjimin e tyre;
15. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së zbatimit të procedurave të kontrollit dhe testimit të makinerive pas riparimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të mbikëqyrë proceset e riparimit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
2. Të mbikëqyrë proceset e mirëmbajtjes së makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të organizojë punën për korrigjimin e parregullsive pas riparimit.

Kriteret e vlerësimit

- Koordinon proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes me specialistët përkatës, sipas rastit;
- Mbikëqyr proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes së makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas procedurës;
- Mbikëqyr zbatimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas kalendarit;
- Mbikëqyr plotësimin e librit të shërbimeve të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas procedurës;
- Monitoron procesin e kolaudimeve periodike të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas kalendarit;
- Monitoron makineritë, mjetet dhe pajisjet e punës për kalibrim, sipas nevojës;
- Informon në kohë specialistët për parregullsi në makineritë, mjetet dhe pajisjet e punës;
- Mbikëqyr riparimin e defekteve në pjesët mekanike, sipas procedurës;
- Mbikëqyr procesin e çmontimit/montimit dhe zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas procedurës;
- Mbikëqyr zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara, sipas procedurës;
- Mbikëqyr procesin e regjistrimit të detaleve dhe nyjeve pas riparimit /zëvendësimit, sipas procedurës;
- Mbikëqyr proceset e vajosjes dhe grasatimit, sipas procedurës;
- Mbikëqyr kontrollin për testimin e makinerive pas riparimit, sipas procedurës.

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë zbatimin e legjislacionit bazë në fushën e mekanikës dhe parimet bazë të kodit të punës,
2. Të klasifikojë llojet e dokumentacioneve teknike dhe financiare;
3. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të procedurave, format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
4. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së kostove të materialeve, pjesëve të këmbimit dhe të kohës së punës;

5. Të shpjegojë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe ofertat e lëshuara klientëve;
6. Të argumentojë rëndësinë e informimit nga tregu për çmimet dhe cilësinë e makinerive, materialeve, pajisjeve, mjeteve dhe veglave të punës;
7. Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes së çmimit të një oferte, produkti apo shërbimi;
8. Të shpjegojë rëndësinë e teknikave të marketingut në biznes;
9. Të identifikojë interesat, aftësitë personale dhe profesionale duke përdorur metoda të ndryshme, përfshirë procesin e vetëvlerësimit;
10. Të shpjegojë rëndësinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita sipas nevojave dhe interesave të industrisë.
11. Të identifikojë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
12. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të teknologjive bashkëkohore për proceset e punës;
13. Të argumentojë rëndësinë e transmetimit në kohë të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë, tek bashkëpunëtorët.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë detyrat administrative dhe tregtare;
2. Të zbatojë teknikat e marketingut;
3. Të zhvillohet për ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr zbatimin e plotë të legjislacionin tatimor, kodit të punës lidhur me aktivitetin që kryen;
- Mbikëqyr zbatimin e një plani të thjeshtë biznesi, sipas specifikave përkatëse;
- Identifikon në kohë çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit;
- Kryen llogaritje të sakta të kostos së mjeteve, materialeve, pajisjeve, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve në bazë të detyrës së dhënë;
- Kryen llogaritjet për çmimin përfundimtar për shërbimet e ofruara, sipas procedurës;
- Zbaton teknikat e marketingut në biznes;
- Identifikon tregjet dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje;
- Bashkëpunon me institucione financiare, sipas legjislacionit dhe nevojës;
- Regjistron të dhënat e faturave sipas procedurës;
- Kryen hartimin, ruajtjen dhe arkivimin e raporteve ditore, javore, mujore të punës, sipas rregullores së brendshme;
- Shkëmben udhëzime me bashkëpunëtorët për realizimin e detyrës së punës duke përdorur teknologjitë bashkëkohore;
- Kryen vlerësimin individual të aftësive, sipas nevojës referuar proceseve të punës;
- Kryen trajnime për ngritje profesionale dhe teknika të reja në punë;
- Ndjek takime në panaire dhe ekspozita për zhvillimet e teknologjive të reja.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
2. Të argumentojë zbatimin e rregullave bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
3. Të shpjegojë rëndësinë e parimeve kryesore të punës në grup dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
4. Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
5. Të shpjegojë parimet bazë të kodit të etikës në punë;
6. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët, eprorët dhe klientët;
7. Të analizojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
8. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë teknike dhe profesionale gjatë punimeve në repart;
9. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit;
10. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së kufidencialitetit të procesit të prodhimit;
11. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
12. Të përshkruajë rëndësinë e koordinimit dhe rregullat e komunikimit me teknikët e specialistët e tjerë.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë teknikat e komunikimit;
2. Të zbatojë kodin e etikës në komunikimin me të tjerët;
3. Të përdorë terminologji profesionale gjatë komunikimit.

Kriteret e vlerësimit

- Shkëmbejnë informacion për problemet dhe të rejat e ditës, sipas rastit;
- Zbaton rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Koordinon saktë punën në grup me teknikët dhe specialistët e tjerë në veprimtarinë profesionale;
- Respekton hierarkinë, sipas organigramës;
- Zbaton kodin e etikës dhe komunikimit në punë;
- Jep zgjidhje për problematikat gjatë punës në mënyrë etike dhe profesionale;
- Përdor terminologji teknike dhe profesionale gjatë punimeve në repart;
- Përdor teknologji të reja të informimit dhe komunikimit;
- Ruan kufidencialitetin e procesit të prodhimit, sipas rregullores së brendshme;
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.

NjN-06-IV-0265-25 Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në mekanikë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të standardeve dhe legjislacionit shqiptar të rregullave të sigurimit teknik;
2. Të identifikojë domosdoshmërinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës për sigurimin teknik;
3. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti dhe mjetet përkatëse;
4. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të sinjalistikave në mjedisin e punës;
5. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të tabelave të sigurisë teknike dhe rrethimit;
6. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të procedurave të evakuimit në raste emergjence;
7. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të përdorimit të mjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe të kutisë së MZSH-së³;
8. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të solucionave me përmbajtje kimike të rrezikshme;
9. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të sigurisë;
10. Të identifikojë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
11. Të analizojë mënyrat e përdorimit racional të energjisë dhe materialeve;
12. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
13. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregulloreve përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
14. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
15. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të protokolleve në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik;
2. Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe higjienës.

Kriteret e vlerësimit

- Mbikëqyr zbatimin me përpikëri të standardeve dhe legjislacionin shqiptar në fuqi për rregullat e sigurimit teknik;
- Mbikëqyr zbatimin e manualeve përkatëse në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurimit teknik;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga rryma elektrike;
- Mbikëqyr respektimin e sinjalistikës në mjediset e ndërtesës sipas rregullores së brendshme;
- Jep ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Zbaton planin e evakuimit në raste emergjence, sipas procedurës përkatëse;

³ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

- Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
- Mbikëqyr zbatimin e rregulloreve përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike, sipas llojit;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullave për përdorimin racional të burimeve (ujë, energji etj.), si dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Mbikëqyr zbatimin e rregullores për ndarjen e mbetjeve sipas llojit;
- Mbikëqyr depozitimin e mbetjeve në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Mbikëqyr përzgjedhjen e pajisjeve të mbrojtjes individuale dhe kolektive sipas rregullave të sigurimit teknik;
- Mbikëqyr zbatimin në mënyrë rigoroze të protokolleve të duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikë	10	NjN-06-IV-0261-25
2	Proceset e prodhimit në mekanikë	25	NjN-06-IV-0262-25
3	Cilësia e produkteve të prodhuara në mekanikë	20	NjN-06-IV-0263-25
4	Mirëmbajtje dhe riparime mekanike	25	NjN-06-IV-0264-25
5	Sipërmarrje dhe edukim karriere	10	NjN-23-IV-0005-24
6	Komunikimi dhe etika profesionale	5	NjN-22-IV-0006-24
7	Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në mekanikë	5	NjN-06-IV-0265-25
Totali		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit.

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësim nxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- d) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- e) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- f) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: K-F-IV-25

K – Kualifikim

F – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

IV – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK -së

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: NjN-06-IV-0261-25

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

06 - Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

IV - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK -së

0261 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit